



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 473/4 Prot.

Tiranë, më 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 157, Datë 08.06.2026

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 63, datë 02.03.2026, e bërë nga Shoqata “Sonce”, e përfaqësuar nga z. V.S kundër Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, përfaqësuesi i shoqatës në mes të tjerash informon se: “Kjo ankesë paraqitet në emër të 9 (nëntë) personave, pjesëtarë të pakicës kombëtare maqedonase, ndër të cilët jam i përfshirë edhe unë, si Kryetar i Shoqatës “Sonce”.

Ne kemi aplikuar pranë këtij Komisioni me formularët e vetidentifikimit, në përputhje me VKM nr. 843, datë 26.12.2024, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”.

Megjithatë, Komisioni na ka kthyer mbrapsht formularët me arsyetimin se të dhënat e përshkruara në rubrikën e fundit të formularit janë dhënë në mënyrë të përgjithshme dhe se kjo rubrikë duhet të plotësohet në mënyrë shteruese dhe konkrete, duke përfshirë të gjitha karakteristikat dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës kombëtare maqedonase.

Theksojmë se rubrika në fjalë përmban vetëm tre rreshta. Në formularin tim personal, unë kam deklaruar qartë dhe konkretisht: “Jam maqedonas, me gjuhë amtare maqedonase, me prindër maqedonas. Traditat, veshjet popullore dhe kultura që ka familja ime janë maqedonase”.

Nuk është e arsyeshme dhe as proporcionale që nga pjesëtarët e një pakice kombëtare të kërkohet një analizë akademike apo përshkrim i detajuar shkencor mbi folklorin, traditat dhe zakonet, sidomos kur hapësira fizike e formularit është e kufizuar në tre rreshta.

Nga informacionet publike dhe praktika e deritanishme e këtij Komisioni, rezulton se janë miratuar mbi 600 aplikime për pakicat e tjera kombëtare pa iu nënshtruar kërkesave të tilla shtesë dhe pa u kthyer formularët për plotësim me të njëjtin standard rigoroz si në rastin tonë. Ky trajtim i diferencuar përbën diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike.

Të nëntë aplikuesit janë nga zona e Prespës, Bashkia Pustec, ku pakica kombëtare maqedonase njihet zyrtarisht. Deri në vitin 2011, përpara heqjes së rubrikës së kombësisë nga certifikatat e gjendjes civile, në dokumentet zyrtare të gjendjes civile ishte e shënuar kombësia maqedonase për pjesëtarët e kësaj pakice. Në regjistrat e gjendjes civile të Bashkisë Pustec para vitit 2011 figuron e shënuar kombësia maqedonase për pjesëtarët e komunitetit.

Gjithashtu, ndër aplikuesit është edhe z. A.P, aktualisht nënkryetar i Bashkisë Pustec, të cilit po ashtu i është kthyer formulari për plotësim. Në rastin tim personal, si aktivist prej mbi 20 vitesh për të drejtat e pakicës kombëtare maqedonase, ish-deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe person publik i njohur për angazhimin tim në mbrojtje të kësaj pakice, kthimi i formularit përbën një akt që perceptohet si përpjekje për dekurajimin e aplikimeve nga pjesëtarët e pakicës kombëtare maqedonase”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare në raport me aplikimet e pjesëtarëve të pakicave të tjera dhe rekomandimin e pranimit të formularit ekzistues të plotësuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me aplikimet për vetidentifikim si pakicë kombëtare.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 473/1, datë 27.03.2026, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Me shkresën nr. V-04/3, datë 03.04.2026, Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Z. V.S, ka paraqitur formularin e vetidentifikimit, protokolluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me nr. V-04, datë 27.01.2026, në bazë të të cilit është kërkuar vetidentifikimi si pakicë kombëtare maqedonase.*

Gjatë shqyrtimit të formularit të vetidentifikimit ka rezultuar se, të dhënat në rubrikën e fundit të këtij formulari, janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme. Bazuar në parashikimet ligjore sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, nga ana jonë janë dhënë sqarimet përkatëse për plotësim në mënyrë shteruese/konkrete të karakteristikave dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës kombëtare maqedonase për të cilën ai vetidentifikohet, siç edhe specifikohet kërkesa në formularin tip të vetidentifikimit, të miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 843, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”. Pra, në asnjë rast, Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare, nuk ka kërkuar analizë akademike apo përshkrime të detajuara shkencore mbi folklorin, traditat dhe zakonet. Kërkesa për saktësim nuk lidhet me nivelin e detajimit të përshkrimit, por me nevojën që karakteristikat e përmendura të jenë të shprehura në mënyrë konkrete. Pra, edhe një përshkrim i shkurtër është i mjaftueshëm nëse përmban elementë të qartë dhe identifikues të karakteristikave kulturore, etnike, gjuhësore, tradicionale ose fetare të pakicës.

Kjo rubrikë ka për synim të mundësojë paraqitjen sa më të qartë dhe konkrete të elementëve që karakterizojnë dhe identifikojnë pakicën përkatëse. Për këtë arsye, në këto raste është kërkuar plotësim i kësaj rubrike, me qëllim që formulari të përmbajë të dhëna më të plota dhe më konkrete.

Në përgjigjen e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare me nr. V-04/1, datë 16.02.2026, kemi kërkuar gjithashtu se, pas plotësimit të kësaj rubrike, formulari të dërgohet përsëri në komision për shqyrtim, formular i cili nuk rezulton të jetë depozituar më nga ana e kërkuarit.

Lidhur me pretendimin tjetër të z. V.S se, nga ana e Komisionit janë miratuar mbi 600 aplikime, pa iu nënshtruar kërkesave të tilla shtesë dhe pa kthyer formularët për plotësim, ju sqarojmë se, nga Sekretariati Teknik i Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, janë administruar në total 1024 formularë vetidentifikimi (përfshirë edhe rastet kur një shtetas ka përcjellë më shumë se një herë formularin e vetidentifikimit, si dhe rastet të cilat janë në proces shqyrtimi).

Përgjatë periudhës maj 2025–mars 2026, Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare ka realizuar 5 (pesë) mbledhje dhe ka marrë në total 473 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në një pakicë kombëtare të caktuar, konkretisht: 210 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare egjiptiane; 201 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare bullgare; 52 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare rome; 7 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare malazeze; 1 vendim për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare maqedonase; 1 vendim për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare greke dhe 1 vendim për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare boshnjake. Pra, nga Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare janë marrë në total 473 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit në një pakicë kombëtare dhe jo mbi 600 vendime siç pretendohet nga ankuesi.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se, kjo praktikë nuk është zbatuar në mënyrë të diferencuar apo diskriminuese në bazë të përkatësisë etnike, sikundër pretendohet, pasi në të njëjtën mënyrë janë shqyrtuar dhe kthyer për plotësim edhe formularë të paraqitur nga pjesëtarë të pakicave të tjera, kur informacioni i dhënë ka rezultuar të jetë i përgjithshëm dhe jo i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e rubrikave të formularit. Rezulton se, nga 1024 formularë të depozituar, janë kthyer 486 formularë vetidentifikimi, për këtë arsye por edhe për arsye të tjera, duke bërë që 478 formularë t’u kthehen për plotësime dhe saktësime shtetasve që kanë kërkuar të vetidentifikohen në pakicën kombëtare egjiptiane, bullgare, rome, malazeze dhe greke, si dhe vetëm 8 raste janë kthyer (jo refuzuar) për shtetas të cilët kanë kërkuar të vetidentifikohen si pakicë kombëtare maqedonase.

Ndërkohë, rezulton se, formulari i vetidentifikimit, i cili është plotësuar në mënyrë të plotë dhe të saktë, po nga pjesëtari i kësaj pakice, është marrë në administrim dhe si rrjedhojë është marrë vendimi përkatës për konfirmimin e vetidentifikimit në pakicën kombëtare maqedonase, konkretisht për shtetasen M.M, nëpërmjet vendimit nr. 111, datë 23.02.2026 “Për konfirmimin e vetidentifikimit si pjesëtar i pakicës kombëtare maqedonase” të Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare.

Këto çështje janë sqaruar gjithashtu edhe gjatë mbledhjes së fundit të Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare më datë 23.02.2026, në të cilën ka qenë e pranishme edhe përfaqësuesja e institucionit të Avokatit të Popullit por edhe përfaqësuesi i shoqatës “Sonce”, z. E.F (anëtar i Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare), i cili e ngriti si çështje për diskutim.

Veprimtaria e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare rregullohet duke u bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 843, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave

kombëtare” dhe VKM-së nr. 845, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurave të komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”.

Gjithashtu, lidhur me hartimin e udhëzimeve se si duhet të plotësohet formulari i vetidentifikimit, ju informojmë se, gjatë muajit Mars 2026, Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Komitetin e Pakicave Kombëtare, kanë organizuar tre tryeza të rrumbullakëta në Kukës, Dropull dhe Korçë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të komuniteteve vendore mbi procedurën e vetidentifikimit si pakicë kombëtare, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

Gjatë këtyre aktiviteteve, pjesëmarrësit janë njohur me dy materiale praktike, të cilat synojnë të lehtësojnë procesin e vetidentifikimit, konkretisht:

- Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile, i hartuar për të mbështetur përfaqësuesit e pakicave dhe ndërmjetësit komunitarë në asistimin e individëve gjatë gjithë procesit;
- Fletë informuese e dedikuar për publikun e gjerë, veçanërisht për personat që u përkasin pakicave kombëtare, me informacion të vlefshëm mbi mënyrën e plotësimit të formularit të vetidentifikimit dhe vendin ku ai mund të dorëzohet.

Në përfundim, sqarojmë se, kthimi i formularëve, në rastin e vetidentifikimeve të kryera nga pakica maqedonase, si dhe të gjithë pakicat e tjera, ka patur vetëm karakter administrativ dhe është bërë për të mundësuar plotësimin e plotë të formularit, sipas kërkesës së rubrikës. Është e rëndësishme të theksohet se, ky veprim nuk ka synuar dhe nuk përbën në asnjë rast mohim të së drejtës për vetidentifikim apo refuzim të vetidentifikimit të kryer”.

- Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet email-it datë 21.04.2026, është njohur me përgjigjen e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, por nuk ka kthyer përgjigje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me pretendimin e Shoqatës “Sonce” për diskriminim të anëtarëve të saj, nga ana e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e

depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të Ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”*.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me legjitimimin e Shoqatës “Sonce” dhe të z. V.S, për të paraqitur ankesë në emër të disa personave të tjerë, pranë Komisionerit.

Për këtë arsye, me email-in, datë 09.03.2026, Inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, informacionin dhe dokumentacionin, si më poshtë:

“Në formularin e ankesës dhe në dokumentacionin e dorëzuar, ndër të tjera keni paraqitur ankesë në emër dhe të 8 personave të tjerë, pjesë të pakicës kombëtare maqedonase.

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative, Shoqata “Sonce” dhe z. V.S, nuk legjitimohen që të përfaqësojë shtetasit: P.S; P.P; S.M; A.P; D.M; S.P; S.P; F.P; pasi ata janë persona madhor, kanë aplikuar në mënyrë individuale pranë Komisionit, dhe nuk rezulton se kanë lëshuar ndonjë deklaratë që kërkojnë të përfaqësohen nga z. V.S apo Shoqata. Në këto kushte shtetasit e sipërpërmendur mund ti drejtohen Komisionerit me ankesa të veçanta ose të plotësojnë një deklaratë individuale që pranojnë të përfaqësohen nga Shoqata/z. V.S.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, evidentohet se për legjitimimin e Shoqatës “Sonce” përpara Komisionerit, keni bashkëngjitur ankesës: kopje të Vendimit nr. 2986, datë 11.01.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e shoqatës në gjykatë, dhe kopje të Statutit të shoqatës, datë 09.12.2010, por nuk keni depozituar një vendim të rifreskuar të zgjedhjes së Kryetarit të Shoqatës, pasi në nenin 13 të Statutit citohet se: “Kryetari i Shoqatës dhe anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje”. Në kuptim përsa sipërcituar, vlerësohet se për legjitimimin e Shoqatës “Sonce”, përfaqësuar nga z. V.S, nevojitet depozitimi i një akti të zgjedhjes së Kryetarit të shoqatës”.

Me gjithë kalimin e afatit kohor të përcaktuar për plotësimin e anës formale të ankesës¹, nga e z. V.S, si përfaqësues i Shoqatës “Sonce”, nuk u depozitua dokumentacioni përkatës lidhur me legjitimimin e tij për përfaqësimin e Shoqatës përpara Komisionerit.

Pika 1 e 2, të nenit 33, të LMD-së, parashikojnë se:

“1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.

¹ Afati i lënë për plotësimin e saj ishte deri me datë 18.03.2026.

2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, Shoqata “Sonce” dhe z. V.S, nuk legjitimohen për të paraqitur ankesë në emër të shtetasve: P.S; P.P; S.M; A.P; D.M; S.P; S.P; F.P.²

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 1 dhe 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se do vijojë procedurat e trajtimit të ankesës, vetëm për ankesën e z. V.S.

B. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të z. V.S

Z. V.S, ka paraqitur formularin e vetidentifikimit, të protokolluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me nr. V-04, datë 27.01.2026, në bazë të të cilit është kërkuar vetidentifikimi si pakicë kombëtare maqedonase. Në rubrikën për përshkrimin e karakteristikave dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale, ankuesi ka shkruar: *“Jam maqedonas, me gjuhë amtare maqedonase, me prindër maqedonas. Traditat, veshjet popullore dhe kultura që ka familja ime janë maqedonase”*.

Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare me shkresën nr. V-04/1, datë 16.02.2026, “Kthim përgjigje”, ka informuar ankuesin se, të dhënat në rubrikën e fundit të formularit, janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme dhe se duhet të plotësohen në mënyrë shteruese dhe konkrete të gjithë karakteristikat dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës kombëtare maqedonase.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurat në lidhje me njohjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, përcakton se ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave

² Për analogji citojmë Vendimet nr.12, datë 23.01.2023 dhe nr. 247, datë 23.09.2024, të KMD-së.

kombëtare, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2 i ligjit nr. 96/2017, përcakton se qëllimi i ligjit është sigurimi i ushtrimit të të drejtave specifike të personave që u përkasin pakicave kombëtare, të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të tyre, duke garantuar mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit.

Neni 3, pika 1, i ligjit nr. 96/2017, përcakton se pakicë kombëtare është grupi i shtetasve shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm. Po ky nen, në pikën 2, njih si pakica kombëtare në Republikën e Shqipërisë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

Neni 5, pika 1, i ligjit nr. 96/2017 parashikon se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që lidhen me këtë zgjedhje.

Neni 6, pika 1, i ligjit nr. 96/2017 parashikon të drejtën e vetidentifikimit, duke përcaktuar se çdo person ka të drejtë të deklarojë përkatësinë në një pakicë kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit. Pika 2 e këtij neni ndalon detyrimin e personit për të zbuluar ose bërë publike të dhëna mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

Neni 7 i ligjit nr. 96/2017 rregullon mbledhjen e të dhënave, duke përcaktuar se institucionet publike mbledhin të dhëna për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit dhe në dokumentacionin e gjendjes civile, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Pika 2 e këtij neni parashikon se kriteret, dokumentacioni dhe procedurat përkatëse miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të kësaj dispozite është miratuar VKM nr. 843, datë 26.12.2024 *“Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”*.

Sipas pikës 1 të VKM-së nr. 843/2024, mbledhja e të dhënave për identifikimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare kryhet në përputhje me të drejtën e tyre për vetidentifikim të lirë. Sipas pikës 2, personi që pretendon se i përket një pakice kombëtare dhe kërkon të identifikohet si i tillë paraqet formularin e vetidentifikimit, sipas aneksit 1 të vendimit, pranë komisionit të ngritur në ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme.

Pika 4 e VKM-së nr. 843/2024 përcakton se Komisioni pranon vetidentifikimin dhe pasqyron të dhënat në listën përkatëse për pakicat kombëtare brenda 30 ditëve nga depozitimi i formularit të vetidentifikimit. Në raste përjashtimore, pika 5 lejon verifikim të mëtejshëm vetëm kur ka arsye që hedhin dyshime serioze për saktësinë e të dhënave të vetidentifikuara.

Në rast se kryhet verifikim, pika 9 e VKM-së parashikon se Komisioni rishikon dokumentacionin duke i dhënë peshë vendimtare zgjedhjes subjektive të individit, ndërsa faktorë si gjuha, feja, kultura ose traditat ofrojnë një bazë të mjaftueshme për qëllimin e vetidentifikimit.

Pika 13 e VKM-së përcakton se Komisioni merr vendim për konfirmimin ose jo të vetidentifikimit brenda 60 ditëve nga data e inicimit të verifikimit dhe, në rast se nuk merret vendim brenda afatit, vetidentifikimi konsiderohet i konfirmuar. Pika 14 kërkon që vendimi i arsyetuar i Komisionit t'i njoftohet menjëherë personit, ndërsa pikat 15–17 parashikojnë të drejtën e apelimit dhe më pas të ankimit në gjykatën administrative.

Komisioneri vlerëson se e drejta e vetidentifikimit është një e drejtë me rëndësi të veçantë në sistemin e mbrojtjes së pakicave kombëtare, pasi lidhet drejtpërdrejt me identitetin personal, përkatësinë etnike/kombëtare, gjuhësore, kulturore dhe tradicionale të individit.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk ushtrohet jashtë çdo procedure. Vetë ligji nr. 96/2017, në nenin 7, pika 2, ia ka deleguar Këshillit të Ministrave përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave. Për rrjedhojë, VKM nr. 843/2024 nuk kufizon të drejtën e vetidentifikimit, por përcakton mënyrën procedurale për ushtrimin dhe administrimin e saj.

Në këtë kuptim, Komisioni pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme nuk vepron si organ që jep ose mohon në mënyrë arbitrare identitetin e një personi, por si organ administrativ që administron procedurën, formularin, afatet, verifikimin eventual dhe pasqyrimin e të dhënave në listën përkatëse.

Nga aktet e administruara rezulton se mospranimi i aplikimit të z. V.S nuk është bërë për shkak të përkatësisë së pretenduar të tij në një pakicë kombëtare, por për shkak të zbatimit të procedurës së njëjtë që parashikohet në VKM nr. 843/2024 për çdo person që kërkon të vetidentifikohet.

Komisioneri çmon se nëse Komisioni ka konstatuar mungesë të formularit të rregullt, mungesë të elementeve të kërkuara në aneksin 1, mospërmbushje të mënyrës së paraqitjes, mungesë të dokumentacionit ndihmës në rast verifikimi, ose ka ndjekur procedurën e parashikuar për verifikim të mëtejshëm, këto veprime janë pjesë e kompetencës së tij ligjore dhe nuk përbëjnë, në vetvete, trajtim të pafavorshëm.

Në udhëzuesin e përgatitur në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Fuqizimi i mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri”, për plotësimin e formularit të vetidentifikimit, udhëzohen aplikuesit se si duhet të plotësohet ky formular, si më poshtë: “Cfarë duhet patur parasysh në plotësimin e formularit?”

Formulari duhet të plotësohet në tërësinë e tij, pra në çdo rubrikë. Pjesa që rezulton më komplekse për tu plotësuar është pyetja e fundit në lidhje me karakteristikat dalluese etnike, kulturore, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që personi pretendon se i përket.

Pjesa e fundit e formularit, që ka të bëjë me karakteristikat dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që personi pretendon se i përket, është veçanërisht e rëndësishme që jo vetëm të plotësohet, por të plotësohet me kujdes.

Këto karakteristika mund të jenë përveç gjuhës së pakicës që i përkisni, një këngë, instrument apo zakon festimi, një ditë e veçantë festimi që i përket komunitetit tuaj. Një profesion që karakterizon pakicën tuaj. Për shembull: Tradita e punimit e thurjes së kashtës, punimi i hekurit, marrja me blegtori, valle tradicionale, etj”.

Pra, nga ana e institucioneve, është theksuar fakti, se nga ana e aplikuesve duhet të jepet një informacion sa më i plotë i karakteristikave dalluese etnike, kulturore, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që personi pretendon se i përket.

Referuar informacionit të shkresës nr. V-04/3, datë 03.04.2026, të Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, rezulton se Komisioni ka marrë 473 vendime për konfirmimin e vetidentifikimit të aplikuesve që i përkisnin pakicës kombëtare egjiptiane, bullgare, rome, malazeze, maqedonase, greke dhe boshnjake dhe nga ana e Komisionit nuk ka pasur trajtim të pafavorshëm për ankuesin, për shkakun e pretenduar prej tij, pasi Komisioni për njohjen e Pakicave Kombëtare ka konfirmuar e vetidentifikimit edhe të një aplikuesi që i përket pakicës kombëtare maqedonase, të njëjtë si ankuesi.

Komisioneri vlerëson se vendimmarrja administrative që bazohet në kritere procedurale të njohura paraprakisht dhe të zbatueshme për të gjithë, nuk përbën diskriminim, për sa kohë nuk provohet se këto kritere janë përdorur në mënyrë selektive ose me qëllim përjashtues ndaj një personi për shkak të etnisë së tij.

Në rastin konkret, nuk rezulton që persona të tjerë të kenë paraqitur aplikime me të njëjtat mangësi procedurale dhe ato të jenë pranuar nga Komisioni. Po ashtu, nuk rezulton që Komisioni të ketë përdorur dy standarde të ndryshme: një standard më lehtësues për aplikantë të tjerë dhe një standard më kufizues për z. V.S. Përkundrazi, të dhënat krahasuese tregojnë se standardi procedural është zbatuar në mënyrë të njëjtë dhe për aplikantët që pretendojnë përkatësi në pakica të ndryshme kombëtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se z. V.S nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për njohjen/vetidentifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga Shoqata “Sonce”, e përfaqësuar nga z. V.S, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. V.S, për shkak të etnisë, nga ana e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)